



## Përditësim për shtypin

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në çështjen gjyqësore të Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit and Jakup Krasniqit, Trupi Gjykses lëshoi më 1 korrik urdhrin për caktimin e datës për shqiptimin e verdiktit në atë çështje. Seanca do të mbahet më 16 shtator, në orën 10:00. Për ta përcjellë seancën duhet të bëhet regjistrim paraprak. Ajo mund të ndiqet gjithashtu edhe përmes funksionit të transmetimit në faqen e internetit të Dhomave të Specializuara, në tri gjuhët e gjykatës, shqipe, serbishte dhe anglishte.

Po më 1 korrik, Trupi Gjykses lëshoi një urdhër me të cilin i kujtoi përsëri Hashim Thaçit kushtet e modifikuara të paraburgimit të vendosura për të, si edhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera në lidhje me paraburgimin e tij. Trupi Gjykses urdhëroi gjithashtu mbrojtësit që t'i rikujtojnë z. Thaçi detyrimet përkatëse. Bazuar në raportimet e rregullta të Administratores, Trupi Gjykses arriti në përfundimin se z. Thaçi kishte shfaqur në mënyrë të përsëritur sjellje që ishin në shkelje të kushteve të modifikuara dhe rregullave dhe rregulloreve të tjera të paraburgimit. Në qoftë se z. Thaçi nuk do t'i respektojë ato, Trupi Gjykses do të shohë mundësinë e masave edhe më të rrepta për të siguruar respektimin e urdhrave të tij.

Më 24 qershor, Trupi Gjykses miratoi pjesërisht një kërkesë të përbashkët të Mbrojtjes për të mos pranuar ndryshimet që Prokuroria i kishte bërë dosjes gjyqësore përfundimtare të saj. Prokuroria dorëzoi një version të dosjes gjyqësore përfundimtare, ku kishte bërë tri ndryshime në poshtëshënime. Korrigjime të gabimeve të vogla të shtypit lejohen në rrethana të caktuara, përpara se të lëshohet vendim mbi parashtrimin përkatës. Trupi Gjykses lejoi dy ndryshime në poshtëshënimet e dosjes gjyqësore përfundimtare dhe nuk pranoi një ndryshim me të cilin Prokuroria kishte shtuar një referencë, sepse kjo do të përbënte provë materiale shtesë dhe, rrjedhimisht, hyn në kategorinë "parashtrime të mëtejshme", të cilat bien jashtë kuadrit të lejueshëm.

Në gjykimin e Hashim Thaçit, Bashkim Smakajt, Isni Kilajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit lidhur me ndikim të pretenduar ndaj dëshmitarëve, Paneli i Apelit miratoi pjesërisht një apel të Prokurorisë kundër një vendimi të Gjykatës të Vetëm mbi pranimin e aktekspertizës së një dëshmitari dhe udhëzoi Gjykatësin e Vetëm që të rivlerësojë pranueshmërinë e provës përkatëse në përputhje me vendimin e Panelit të Apelit.





Prokuroria kërkoi pranimin e aktekspertizës dhe dëshmisë së një dëshmitari ekspert, që ishte i specializuar në kryerjen e një analize specifike. Megjithatë, Gjykatësi i Vetëm kishte hedhur poshtë pranueshmërinë e aktekspertizës, sepse metoda nuk ishte e pranuar gjerësisht në qarqet akademike, dëshmitari nuk ishte i gatshëm ta zbulonte plotësisht metodologjinë e tij, dhe Prokuroria nuk kishte marrë autorizim sipas rregullës 107 për ta mbajtur konfidencial atë informacion.

Dhoma e Apelit konstatoi se Gjykatësi i Vetëm duhet të kishte zbatuar standard më të ulët shqyrtimi për të vendosur mbi pranueshmërinë e provës, konkretisht nëse ajo është e mbështetshme *prima facie*, që do të thotë nëse dëshmitari, në shikim të parë, mund të konsiderohet ekspert i fushës. Sipas mendimit të Dhomës së Apelit, transparenca absolute për secilin hap të metodologjisë së përdorur nuk është e domosdoshme për pranimin e provave. Duke qenë se dëshmitari shpjegoi si duhet parametrat e përgjithshëm dhe kontrollat e brendshme të cilësisë, Dhoma e Apelit konstatoi se aktekspertiza e tij ishte mjaftueshmërisht transparente për qëllime të pranueshmërisë. Pasi eksperti të pranohet si dëshmitar, do t'i takojë Gjykatësit të Vetëm që të vendosë se çfarë peshe do t'i japë kësaj prove.

Dhoma e Apelit konstatoi gjithashtu se rregulla 107 nuk ishte rregulla e zbatueshme në kuptimin e ngushtë të fjalës, sepse informacioni i ndjeshëm që dëshmitari nuk pranoi ta jepte, nuk i ishte dhënë as Prokurorisë para se ai të dëshmonte dhe, rrjedhimisht, Prokuroria nuk kishte detyrimin të mernte paraprakisht autorizim për të. Gjithashtu, duke qenë se Mbrojtja mundi ta mernte në pyetje dëshmitarin në lidhje me këtë temë, Dhoma e Apelit nuk gjykoj se Mbrojtjes i ishte shkaktuar dëm.

Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit ia ktheu këtë pikë Gjykatësit të Vetëm me udhëzimin që të rivlerësojë pranueshmërinë e dëshmitarit ekspert bazuar në konstatimet e Dhomës së Apelit.

Pas këtij vendimi, më 1 korrik, Gjykatësi i Vetëm ftoi palët të dorëzonin parashtime lidhur me këtë aspekt deri më 6 korrik. Ai gjithashtu shfuqizoi të gjitha afatet e mëparshme për dorëzimin e dosjeve gjyqësore përfundimtare të palëve dhe afatet përkatëse.

Më 30 qershor, Gjykatësi i Vetëm urdhëroi palët të riklasifikonin si publike disa transkripte të dëshmimeve të dëshmitarëve dhe të dorëzonin versione të redaktuara publike të disa transkripteve të ngjashme. Sa i takon dëshmisë së një dëshmitari ekspert, Gjykatësi i Vetëm urdhëroi Prokurorinë të kontaktonte punëdhënësin e dëshmitarit për të përcaktuar nëse dëshmia mund të riklasifikohet si publike, apo nëse ka shqetësime lidhur me sigurinë e informacionit ose privatësinë e dëshmitarit.





Më 29 qershor, u bë i disponueshëm versioni i redaktuar publik i vendimit të Gjykatësit të Vetëm mbi kërkesën urgjente të Fadil Fazliut për ndryshimin e kushteve të lirimimit. Më 25 mars, Mbrojtja e z. Fazliu kërkoi që ai të lejohej të udhëtonte jashtë Kosovës për të vizituar një person në fazën e fundit të sëmundjes, që të përshëndetej në mënyrë të njëmendtë me të derisa personi ishte ende në gjendje ta bënte këtë.

Gjykatësi i Vetëm miratoi kërkesën, duke pasur parasysh se udhëtimi i z. Fazliu nuk do të rriste rrezikun e moderuar të identifikuar më parë se ai mund të pengojë ecurinë e procesit, meqë të njëjtat kushte lirimimi vlejné dhe gjatë udhëtimit. Gjykatësi i Vetëm e bazoi vendimin e tij edhe në dosjen mjekësore të personit dhe faktin që personi është i afërm i ngushtë, duke rikujtuar se gjendja e rëndë shëndetësore e një të afërmi të ngushtë ka shërbyer në të kaluarën si bazë për miratimin e lirimimit të përkohshëm.

Gjykatësi i Vetëm gjykoj po ashtu se vizita e kërkuar nuk do të pengonte ecurinë e procesit dhe as të ndikonte negativisht në të drejtat e të akuzuarve të tjerë në këtë çështje për gjykim pa vonesë të papërligjur. Gjykatësi i rikujtoi z. Fazliu se vazhdojnë të jenë në fuqi të gjitha kushtet e tjera të përcaktuara në Vendimin për Lirim dhe e urdhëroi që t'ia kthente pasaportën Zyrës Administrative menjëherë pas kthimit në Kosovë.

Në një vendimin të dytë, që fillimisht u lëshua më 19 qershor 2026, Gjykatësi i Vetëm hodhi poshtë kërkesën e Mbrojtjes së Fazliut për ta lejuar atë të udhëtonte në Mal të Zi për të marrë pjesë në një aktivitet. Gjykatësi i Vetëm konstatoi se nuk ishin treguar arsye bindëse që përligjin ndryshimin e kushteve në fuqi për lirimimin e tij dhe se nuk ishin treguar arsye humanitare bindëse ose ndryshim i konsiderueshëm i rrethanave.

Më 25 qershor, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese rrëzoi në tërësi kërkesën e Pjetër Shalës për mbrojtje të ligjshmërisë në lidhje me urdhrin për zhdëmtim kundër tij. Ndër katër pikat e ngritura, z. Shala parashtroi se Trupi Gjykues kreu një shkelje të konsiderueshme procedurale që zhvilloi procedura të veçanta zhdëmtimi përpara se verdiktet për fajësinë penale të tij të merrnin formë të prerë në shkallën e apelit, dhe se Trupi Gjykues gaboi që gjykoj se ai ishte përgjegjës për kompensimin e dëmit që nuk u shkaktua nga veprimet apo mosveprimet e tij, por nga krimet për të cilat z. Shala u shpall fajtor.

Paneli i Gjykatës Supreme hodhi poshtë parashtrimin e z. Shala në lidhje me rendin e lëshimit të urdhrin për zhdëmtim. Paneli i Gjykatës Supreme vuri në dukje gjithashtu se Paneli i Apelit konstatoi se Trupi Gjykues kishte vendosur saktë se zhdëmtimet duhet të akordohen bazuar në dëmin e





pësuar si rezultat i drejtpërdrejtë i krimeve që përfshihen në juridiksionin e Dhomave të Specializuara në lidhje me të cilat personi ka marrë vendim fajësie, dhe se z. Shala thjesht shprehu mospajtim me interpretimin e Trupit Gjykues dhe të Panelit të Apelit, pa i mbështetur me fakte argumentet e veta.

Në lidhje me pikën e dytë të ngritur nga z. Shala, Paneli i Gjykatës Supreme vuri në dukje se Paneli i Apelit vendosi se standardi i shqyrtimit për procedurat e apelit zbatohet edhe për apelet kundër urdhrave për zhdëmtim dhe, pasi shqyrtoi me kujdes parashtrimet e z. Shala, nuk u bind se Paneli i Apelit kishte gabuar në këtë aspekt.

Paneli i Gjykatës Supreme konstatoi se z. Shala nuk tregoi se ishte kryer shkelje e konsiderueshme e procedurave prej Trupit Gjykues dhe Panelit të Apelit në lidhje me të katër pikat e ngritura dhe e rrëzoi kërkesën referuese në tërësi.

